



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

11.01.2023

02/18



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/_____

Datë: 04.01.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40 paragrafi 2 shkronja (d,e), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 2008", në bazë të nenit 10, nenit 19, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -X- (dhjetë) të rregullt të mbajtur me datë: 28.12.2022 merr këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2022

- 1.Miratohet Raporti i punës nr.02634 datë 20.12.2022 i Komitetit për Komunitete në Komunën e Malishevës për vitin 2022.
- 2.Raporti i punës përfshinë gjithë punën dhe aktivitetet e organizuara për vitin 2022 nga Komiteti për Komunitete.
3. Pjesë përbërse e këtij vendimi është Raporti i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës, përmes Komitetit për Komunitete.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në auteritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi





REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNES-MALISHEVE
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVE-SKUPSTINA OPSTINE MALISEVO



KOMUNA MALISHEVË

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 20-12-2022
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 02/634

Nga: KOMITETI PËR KOMUNITETE

DATE : 19 / 12 / 2022

Përmes: Komitetit për politikë dhe financa

Për: KUVENDIN E KOMUNËS SË MALISHEVES

Kopje: Arkivit të Komunës

Lënda: SHQYRTIMI DHE MIRATIMI I RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR
KOMUNITETE PËR VITIN 2022

Raporti njëvjeçar i Komitetit për Komunitete

Malishevë

Dhjetor 2022

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Vizitat në teren
3. Vizita ne shkolla
4. Vizitat dhe takimet e Komitetit per Komunitete
5. Shqyrtimi i project buxhetit 2022-23
6. Raporte bashkëpunimi
7. Aksione humanitare

Hyrje

Të nderuar anëtar të Kuvendit Komunal, Komiteti për Komunitete si trup ndihmës i Kuvendit dhe si komitet I përhershëm , obligativ për vitin 2022 ka mbajtur 11 (njëmbëdhjet mbledhje të rregullta) të cilat kanë shërbyer si mekanizëm për koordinimin e anëtarëve të komunitetit për kryerjen e aktiviteteve sipas planit të punës ku jemi munduar bashkarisht ti përmbahemi dhe ta zbatojmë gjithë vitit.

Ky komitet është themeluar në muajin mars dhe punën e tij e ka bazuar në mbrojtjen e interesave të komunitetit pakicë dhe institucioneve dhe komuniteteve të tjera në Malishevë.

Ky komitet është i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, 2 nga Kuvendi, 2 nga Komuniteti pakicë dhe 1 përfaqësuese e bizneseve.

Gjatë gjithë kësaj kohe të gjithë anëtarët kanë qenë të rregullt në takime dhe kanë ngritur qështje në interes për qytetarët pa dallim etnie, feje, gjinie...

Pas konstituimit të Komitetit për Komunitete është hartuar dhe miratuar nga anëtarët e Komitetit Plani I punës për vitin 2022 , plan ky I bazuar në nevojat dhe kërkesat e komunitetit pakicë, në gjendjen në teren dhe zyrën për komunitete dhe kthim në Malishevë duke u rekomanduar në KPF dhe më pas I njeiti plan është prezantuar në Kuvend para anëtarëve të asamblesë dhe është miratuar unanimisht.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete është pjesë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) që është kategori kushtetuese i përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe themelohet në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi ku kemi ngritur shumë qështje të ndryshme të cilat janë paraqitur nga anëtarët e komitetit apo edhe nga grupe të caktuara të cilat i kanë shprehur përmes nesh.

Një tjetër objektivë kemi edhe bashkëpunimin, shkëmbimin e përvojave të mira me komunat përreth si dhe me përfaqësues të OSBE-së.

Të gjitha mbledhjet e Komitetit për Komunitete janë monitoruar nga OSBE ku jemi vlerësuar maksimalisht për punën dhe angzhimin e anëtarëve të Komitetit duke u renditur si komuna më e sukseshme në realizimin e planit të punës, realizimin e takimeve dhe ndihmën e komunitetit pakicë.

Në Malishevë jetojnë 56 banorë të Komunitetit pakicë.

Në raportin e përgjithshëm janë të përfshira raporte nga aktivitete të realizuara në teren

Takim me Zyrtaren për Komunitete dhe Kthim në Malisheve Znj. Edona Krasniqi, drejtori të ndryshme komunale, Organizata si HANDIKOS,

Shoqata e Pensionistëve, Qendra për punë sociale, Zyra për ndihmë juridike Falas.

Anëtarët e komitetit për komunitete

Amrush Helshani – NISMA -Kryesues i Komitetit

Zamira morina- LDK-Anëtare

Muharrem Islamaj- Përfaqësues I Komunitetit Ashkali

Naser Malisheva-Përfaqësues I Komunitetit Rom

Qendresa Bytyqi- Përfaqësuese e OJQ

Zyra e Komuniteteve në Komunën e Malishevës

Zyra komunale per komunitete dhe kthim dhe riintegrim ka zbatuar programe dhe politika ne mbrojtjen dhe promovimin e te drejtave te komuniteteve dhe te te riadhesuarve. Kemi punuar me Regulloren e QRK-se Nr.01/2018 per riintegrimin e personave te riadhesiar dhe menaxhimin e programit te riintegrimit rregullore QRK Nr. 22/2020 per riintegrimin e personave te riadhesuar. rregullorja QRK nr.01.2018 per kthimin e te zhvendosurve dhe zgjidhje te qendrueshme. Duke orfuar ndihme te parapare ne qasjen e barabarte te komuniteteve ne sherbimet publike, krijimi i kushteve per kthim dhe riintegrim te te zhvendosurve dhe te riadhesuarve. Gjate kesaj periudhe kemi regjistruar 3 riadhesime , nuk ka pasur riadhesim nga komuniteti RAE.

Per komunitete rom, ashkali nuk ka ndonje projekt te veqant, pos PLV-se qe eshte dokument obligativ, si dhe rregullores QRK Nr.02/2018 per kthimin e personave te zhvendosur dhe zgjidhje te qendrueshme.Me komunitetin pakice kemi pasur takime te shpeshta. Zyrtare për Komunitete dhe Kthim Edona Krasniqi.

Vizita në teren në familjet e komunitetit pakicë nga anëtarët e komitetit për komunitete

Në muajin maj janë realizuar vizita në familjet e komunitetit pakicë nga anëtarët e Komitetit për Komunitete, Kryesuesi I Kuvendit dhe Zyrtarja e Komiteteve (Zyra për kthim) në Malishevë. Te shoqëruar nga OSBE.

Qëllimi i vizitave nga ana e anëtarëve të komitetit ishte njoftimi për së afërmi I kushteve të jetesës, kërkesave dhe nevojave të banorëve.

Janë vizituar familjet në fshatin Banjë ku jetojnë 3 familje, me 15 anëtarë.

Kërkesat e tyre ishin kryesisht ndihmë për pako ushqimore, higjienike, dru, kërkesë për lyerje të shtëpisë së Rrahman Kovaqit, rregullim të kanalizimit. Familja e Bekim Kovaqit ka kërkuar ndihmë në zgjerimin e lokalit pasi që ai punon në zëjën e tij të cilën thotë se nuk ka mundësi financiare të zgjerohet dhe të blejë pajisje për shtimin e punës (biznes familjar)

Fëmijet e tyre vijojnë mësimet në SHFMU "NAIM FRASHËRI" në Banjë dhe sipas kontaktit me drejtorin e shkollës Z. Metë Krasniqi jemi njoftuar që vijueshmëria është e rregullt, kontakti me prind është në nivel të duhur, nxënësit e komunitetit pakicë janë të integruar në shoqëri dhe janë pjesë e qdo detyre dhe aktiviteti shkollorë.

Kjo familje ka nxënësit edhe në Gjimnazin Hamdi Berisha e poashtu edhe student të U.P. por sipas kryefamiljarit Z. Kovaqi studimet edhe mund të ndërprehen për shkak që nuk u ofrihet mundësi punësimi në institucionet lokale apo qendrore dhe se largimin nga vendi e shohin si mundësi për punësim sa më të shpejtë.

Përfutuese të Asistencës sociale.

-Vizita e dytë ishte në familjen e Fadil Mazrekut nga Malisheva.

Kjo familje është 10 anëtarëshe, dhe jetojnë në kushte të vështira banimi. Kërkesat e tyre kryesisht në sigurimin e banimit të jetë primare ndërsa ushqimore dhe higjienike sipas mundësive.

Bashkëshortja e Fadilit është e punësuar në QKMF-Malishevë si Pastruese ndërsa djemt e saj janë të papunë.

Vajza e kësaj familje Emine Fadil Mazreku është përfutuese e një banese sociale dhe jeton me fëmijët e saj pasi që është nënë vetushqyese.

Nga kjo familje vijojnë mësimet dy fëmijë në SHFMU "IBRAHIM MAZREKU" Malishevë dhe sipas informacioneve të Drejtoreshes Znj. Rrezarta Mazreku jemi njoftuar që vijueshmëria është e rregullt, kontakti me prind është në nivel të duhur, nxënësit e komunitetit pakicë janë të integruar në shoqëri dhe janë pjesë e qdo detyre dhe aktiviteti shkollorë

Takim me DREJTORINË E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në mbledhjen e IV-të rregullt të Komitetit për komunitete kemi takuar edhe Përfaqësuesin e DSHP-së z.Fadil Shala (Shef i DSHP) takim ky i jashtzakonisht i rëndësishëm përmes së cilit jemi njoftuar për punën dhe angazhimin, shërbimet që ofron kjo drejtori. Ndër të tjera Z,Shala na njoftoi mbi kriteret dhe procedurat e pranimit të familjeve në banesën e banimit social (II) , numrin e familjeve përfituese, përfitueset femra(nëna vetushqyese), 15 gra m kryefamiljare kanë përfituar banim në objektin e banimit social, persona me nevoja të veqanta.

Përkrahja e DSHP-së nuk ka munguar asnjëherë edhe për qytetarët e komuniteteve pakicë. Ata janë ndihmuar sipas mundësive nga institucionet relevante e në këtë rast u përmend angazhimi maksimal i drejtorisë në sistemimin e familjes së komunitetit Rom nga Malisheva në banesën sociale II.

Poashtu shërbimet e varrimit kryhen për të gjitha familjet e komuniteteve nga Bashkësia fetare.

Takim me Zyren për Barazi Gjinore

Anëtarët e Komitetit për Komunitete kanë takuar zyrtaren për barazi gjinore në Komunën e Malishevës Vera BYTYQI ku janë njoftuar mbi punën dhe angazhimin e kësaj zyre. Planin e punës, aktivitetet dhe përfshirjen e grave të komunitetit pakicë.

Jemi njoftuar mbi implementimin e strategjisë komunale kundër dhunës në familje e miratuar nga kuvendi komunal në dhjetor të vitit 2021, fushatën e 16 ditëshit të aktivizimit kundër dhunës dhe diskriminimit gjinorë, fushatën, kampanjën kundër trafikimit të qenjëve njerzore, për muajin tetor si muaji ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, mbajtja e disa takimeve si: Takimi i psikologut me fëmijët dhe prindër, takimi i mjekut dhe ligjerata për vetëdijësimin rreth kancerit të gjirit.

Gjatë tërë muajit tetor do të mbahet, fjongu që simbolizon, solidarizimin me të prekurat me kancer të gjirit, njëherit të gjitha shërbimet janë falas brenda tetorit për identifikimin e kësaj sëmundje.

Takim me HANDIKOS-Malishevë

Anëtarët e Komitetit për Komunitete të shoqëruar nga përfaqësues nga OSBE kemi mbajtur takim në Handikosnë Malishevë.

Puna, angazhimi dhe veprimtaria e kësaj Qendre rehabilitimi është e madhe dhe shumë e rëndësishme për këtë shtresë të shoqërisë. HANDIKOS në Malishevë është shtëpi e dytë për personat me nevoja të veqanta tha Koordinatorja e kësaj Qendre znj. Feride Hoxha.

Kjo qendër është funksionale që 20 vite dhe ofron shërbime për persona me nevoja të veqanta si Fizioterapi, psikoterapi, mjete ortopedike, Avokim, lobim për të drejtat e veqanta për personat.

Pas pavarësimit të kësaj Qendre (6 vite) Aktivitetet vazhdojnë por me vështirësi. Komuna malisheves, ka ndihmuar në mbajtjen e aktiviteteve.

Levizshmëria e vështirësuar, për personat me nevojat e veqanta. Ndertime pa standarte, shkolla pa pjerrtësi për fëmijet me nevoja të veqanta. Aftësi të kufizuara të sjellimit.

Punësimi i personave me nevoja të veqanta është problem shqetësues. Në të gjithë komunën e Malisheves nuk ka shumë persona me nevoja të veqanta të punësuar.

Kërkesë e Handikos ishte Përfshirja e personave me nevojat të veqanta në aktivitete rinore, kulturore e sportive. Sot ka OJQ që marrin projekte dhe thirren në përkrahje të personave me aftësi të kufizuara por asnjëherë nuk i përfshijnë në praktikë. Në Handikos nuk ka anëtarë të komunitetit pakicë. Por nëse ata kanë nevojë për shërbime trajtohen njëjtë si të gjithë qytetarët pa dallim.

Takim me Drejtorinë për Arsimit dhe Edukim në Malishevë

Në mbledhjen e VI-të të rregullt të Komitetit për komunitete kemi takuar edhe Përfaqësuesin e DKAE z. Sabit Berisha, takim ky i jashtëzakonisht i rëndësishëm përmes së cilit jemi njoftuar për punën dhe angazhimin, shërbimet që ofron kjo drejtori. Poashtu mbi përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollorë. Grevën e mësimdhënësve, vijueshmërinë e komunitetit pakicë.

Në komunën e Malishevës janë 12 fëmijë që vijojnë mësimet në shkolla fillore dhe të mesme nga nxënës të komunitetit pakicë nga klasa e I-rë deri në klasën e IX-të, dhe në shkollën e mesme janë dy nxënës të komunitetit ku integrimi i tyre në shkollë është në nivel shumë të mirë.

Nuk ka asnjë mësues të punësuar nga Komuniteti pakicë, ka dy punëtor Teknik.

Nuk ka asnjë fëmijë të pranuar në qerdhe publike.

Bashkëpunimi mësimdhënës nënës dhe prind edhe nga ana e komuniteteve është në nivel të duhur.

Takimet e Kryesuesit te Komitetit për komunitete ne Këshilliin Komunal për Siguri në Bashkësi

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete është pjesë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) që është kategori kushtetuese i përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe themelohet në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Ndër qështjet e ngritura në këto takime ishin:

Mirëmbajtja e ndriqimit public në fshatra.

Shpeshtimi I rasteveve të vjedhjeve , thyerjet e shtepive.

Kërkoj që të shqyrtohet mundësia e vendosjes së matësëve digjital të shpejtësisë ne qytet,

Intervenimi i inspektoriatit në lokalet në të cilat është zërimi shumë i lartë.

Mirëpresim ardhjen mërgimëtarëve në vendlindje dhe organizimin e aktiviteteve per mërgimtarët të organizuara nga Komuna Malishevës. Kërkoj qe të jenë të informuar, duke botuar dhe shpërndarë fletushka, postera, nëper vendbanimet e komunës së Malishevës.

Ne mbledhjen e V-të të KKSB-së në rend të ditës ishte Siguria publike ne Komunen e Malishevës- Gjendja e Komitetit Pakicë në Malishevë.

Në këtë mbledhje kam raportuar mbi punën e Komitetit për Komunitete ku kam marrë përkrahje menjëherë nga FSK për të ndihmuar këto familje me pako higjienike dhe veshmbathje dhe nga Bahksesia islame ne Malisheve me pako ushqimore.

Më 3 nëntor 2022 Njësia për Çështje me Civilë e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka shpërndarë donacion me veshmbathje dhe produkte higjienike për familje të komunitetit RAE në Komunën e Malishevës. Gjithsej kanë përfituar 12 familje ndërsa më 5 nëntorë

SHHB BEREQETI, dega në Malishevë, , kanë ndihmuar me pako ushqimore, higjienike dhe miell 10 familje nga komuniteti Rom dhe Ashkali në Komunën e Malishevës.

Banorët e komunitetit RAE janë shprehur falenderues për këtë ndihmë.

Takim me Shoqatën e Pensionistëve në Malishevë

Në takim me përfaqësuesin e pensionistëve në Malishevë, Rexhep Berishën biseduam për mundësinë e bashkëpunimit në të ardhmen me intencën që të ndihmojnë me përvojat e tyre dhe komunitetin që përfaqësojnë përmes aktiviteteve dhe nevojave të tyre.

Nevojat e tyre ishin kryesisht paisja e zyreve me mjete teknike si Kompjuter, printer, internet.

Vizitë në familjet e Komunitetit pakicë ne Kjeve dhe Stapanicë

Kryesuesi i Komitetit per Komunitete z.Helshani bashkë me koordinatorin e Shoqates Bereqeti në Malishevë Z.Alban Hoxha kanë ndarë pako ushqimore për te gjitha familjet e komunitetit paikicë ne Banjë, Malishevë, Kjevë dhe Stapanicë me këtë rast është njohur për së afërmi me kushtet e jetesës së banorëve të këtij komuniteti.

Edhe këto familje janë të integruara në shoqëri. Gjendje te mirë banimi, ndërsa në Stapanice shumë I nevojshëm ndërtimi I shtëpisë së z.Muharrem Islamaj I cili jeton vetëm me gruan e tij.

Lista e familjeve te komunitetit pakicë në Malishevë

Nr.	Emri dhe mbiemri	Gjinia	Mosha	Vendbanimi
1	HAMDI OSMANI	M	63	Kjeve
2	Bashkeshortja	F	63	Kjeve
3	FATMIR OSMANI	M	42	Kjeve
4	Bashkeshortja	F	42	Kjeve
5	Femijet	M	22	Kjeve
6	//	M	18	Kjeve
7	//	F	20	Kjeve
8	//	F	15	Kjeve
9	//	F	12	Kjeve
10	ARTUR OSMANI	M	32	Kjeve
11	Bashkeshortja	F	30	Kjeve
12	FEMIJET	F	12	Kjeve
13	//	F	11	Kjeve
14	//	F	6	Kjeve
15	//	F	3	Kjeve
16	//	M	8	Kjeve
17	MUHARREM ISLAMAJ	M	67	STAPANICE
18	Bashkeshortja	F	65	STAPANICE
19	NASER MALISHEVA	M	55	KJEVE
20	BASHKESHORTJA	F	48	Kjeve
21	FEMIJET	F	22	Kjeve
22	//	F	16	Kjeve
23	//	F	12	Kjeve
24	ISMET MALISHEVA	M	48	Kjeve
25	BASHKESHORTJA	F	43	Kjeve
26	FEMIJET	M	23	Kjeve
27	//	M	20	Kjeve
28	//	F	13	Kjeve

29	RRAHMAN KOVAQI	M	66	BANJE
30	BASHKESHORTJA	F	50	BANJE
31	BEKIM KOVAQI	M	47	BANJE
32	BASHKESHORTJA	F	44	BANJE
33	FEMIJET	F	25	BANJE
34	//	M	22	BANJE
35	//	M	18	BANJE
36	RAMADAN KOVAQI	M	39	BANJE
37	BASHKESHORTJA	F	34	BANJE
38	FEMIJET	M	17	BANJE
39	//	M	11	BANJE
40	//	M	2	BANJE
41	//	F	8	BANJE
42	FADIL MAZREKU	M	48	MALISHEVE
43	BASHKESHORTJA	F	48	MALISHEVE
44	EMRAN MAZREKU	M	29	MALISHEVE
45	BASHKESHORTJA	F	28	MALISHEVE
46	FEMIJET	M	8	MALISHEVE
47	//	F	6	MALISHEVE
48	ENDRIT MAZREKU	M	21	MALISHEVE
49	BASHKESHORTJA	F	21	MALISHEVE
50	FEMIJE	F	4MUAJ	MALISHEVE
51	LULZIM MAZREKU	M	18	MALISHEVE
52	BASHKESHORTJA	F	18	MALISHEVE
53	EMINE MAZREKU	F	30	MALISHEVE
54	FEMIJET	F	16	MALISHEVE
55	//	F	11	MALISHEVE
56	//	M	12	MALISHEVE

Takim me zyrtarin për ndihmë juridike falas në Komunën e Malishevës.

Në këtë takim u informuam nga afër për punën që bën Zyra për Ndihmë Juridike Falas në Malishevë dhe rezultatet që janë arritur deri më tani, po ashtu u njoftuam që kjo zyre është çdo herë e qasshme ndaj të gjitha kërkesave për ndihmë juridike falas, dhe se misioni i saj është tejet i rëndësishëm në funksion të qytetarëve të cilët kanë nevojë për ndihmë juridike falas. Poashtu kjo zyre u ka ofruar shërbime edhe anëtarë nga komuniteti pakicë, në përgatitjen e lëndës, përgatitjen e dokumenteve.

Zyrtar në zyrën mobile për ndihmë juridike është Agron Kastrati dhe kjo zyre gjindet tek QPS.

Takim me drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Drjetori i Drjetorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, z. Fitim Shala, njoftoi anëtarët e komitetit për komunitete, për aktivitetet e zhvilluara deri në muajin nëntor si drejtori e ku veçoi, mbështetjen apo subvencionimin e organizatave joqeveritare të komunës sonë për projektet që aplikuan, realizimin e tyre në shumë fusha kulturore, arte pamore ekspozita, botime librash, sektorin e sportit, Këshillin Rinor Lokal përfshirjen e komunitetve pakicë, dhe theksoi "që vitin e ardhshëm do t'i rrisim mbështetjen financiare për këto aktivitete kulturore, sportive, botime librash, trashëgiminë kulturore në fushatë përkatëse, artistët individual dhe diasporën në ofrimin e vlerave krijues që bënë në ruajtjen e traditës sonë, pra si drejtori kemi kontribuar në të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar në Komunën e Malishevës e që kishin karakter historiko- kulturor kombëtarë e deri të përrurimi i librave e ekspozitave, presim që fundviti t'i nxjerrë edhe OJQ-t e personalitetet më të sukseshme në krijimtarinë e tyre.

Nuk ka Organizatë joqeveritare të komunitetit pakicë e cila do të merrej direct me kërkesat e të rinjëve apo edhe do të ndikonte edhe me shumë pjesëmarrjen e të rinjëve të komunitetit pakicë në aktivitete rinore kulturore e sportive.

Takim me Kryqin e Kuq -Dega Malishevë

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete ka takuar Koordinatorin e Kryqit të Kuq në Malishevë Z. Isuf Morina ku u njoftuam mbi punën dhe aktivitetin e saj. Kryqi i Kuq është derë për nevojtarët e cila ndihmon të gjithë qytetarët padallim kur është mundësia dhe kur ka donacione për të ndihmuar qytetarët.



Foto nga aktivitetet e Komitetit per Komunitete viti 2022.

Rekomandime

Përkrahje për zgjerim të biznesit ne Banje-Veprimtari e vetme ne Malisheve

Rregullim i infrastrukturës

Përfshirjen e të rinjve të Komunitetit pakicë në aktivitete kulturore, rinore e sportive

Avokim

Përkrahje në subvencione.

Përkrahje për Qendrën e Rehabilitimit Handikos në Malishevë

Krijim i mundësive për qasje në objekt rregullimi i pjerrinave në trotuare të zebrat, për personat me nevojë të veçanta

Pensionistet nevojë për përkrahje në subvencione.

Ndihmë për pako ushqimore dhe higjienike

Përkrahje dhe motivim nga Dkë për vijueshmërinë e fëmijëve në shkollë

Përkrahje me bursa për student

Regjistrim ,pranim në qerdhe për fëmijë të k. Pakic (respektim i ktitereve)

Punësim

Malishevë

Dhjetor 2022

Kryesues i Komitetit për Komunitete

Amrush HELSHANI

